



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 06, dt. 27.06.2023

***MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË NIVELIN E PAGAVE TË FUNKSIONARËVE  
TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË DHE TË PUNONJËSVE  
ADMINISTRATIVË TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2023, SIPAS VKM-së nr.328  
dt.31.05.2023***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2023”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Ligjit nr 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 19 date 21.12.2022 “Mbi miratimin e struktues organizative, klasifikimin nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, dhe të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut per vitin 2023”, si dhe VKM-së nr.328 dt.31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, me propozim të Kryesisë , Këshilli i Qarkut

### V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin në nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të punonjësve të administratës të Këshillit të Qarkut për vitin 2023 sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Efektet financiare do të perballohen nga fondet e lira te pagave, krijuar si pasojë e vakancave si dhe parashikimit për një ritje të mundshme të pagave, të miratuara me buxhetin e vitit 2023 dhe i shtrijnë efektet financiare duke filluar nga data 1 Prill 2023, në zbatim të pikes 15 te VKM-së nr.328 dt.31.05.2023

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut.

Konceptoi O. Beqiraj  
Juristi Gj. Kristo  
Sek. K. Qarkut B. Muço

  


Kryetari i Këshillit të Qarkut  
Ana VERUSHI



**STRUKTURA ORGANIZATIVE E ADMINISTRATËS TË  
KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2023**

V.K.M.328 dt 31.05.2023 Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore

Nr.	Njësia strukturore	Nr punonjësve	Kategoria Lidhja 8	Grupi I diplomës	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Vjetërsi 2%	Paga e pozicionit	Statusi I punonjesit
I	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja1/e				170000	Të zgjedhur
II	Zvendëskryetar i Këshillit të Qarkut	1	Lidhja1/e				125000	Të zgjedhur
III	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	I-b	1	14000	2%	100500	Të emëruar K.Qarkut
IV	<b>Kabineti I Kryetarit</b>							
	Drejtor I kabinetit te kryetarit - Keshilltar juridik	1	I-b	1	14000	2%	112500	Pozicion pune me kontratë
	Keshilltar i maredhenieve me publikun dhe mediat	1	II-b	1,2	11000/12000	2%	85000	Pozicion pune me kontratë
	Keshilltar per Projektet e Bashkimit European	1	II b	1,2	14000/12000	2%	91000	Pozicion pune me kontratë
	Zedhenes i zyres se Kryetarit dhe sherbime te tjera	1	III-b	1,2	14000/12000	2%	63000	Pozicion pune me kontratë
V	<b>Sektori i finances, zhvillimit ekonomik, sherbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit te territorit</b>							
	Pergjegjes I Sektorit te Finances dhe Buxhetit	1	III-a/1	1	14000	2%	80300	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist i nivelit të lartë për Shërbimet, Burimet Njerezore dhe Emergjencat Civile	1	III-b	1,2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist i nivelit të lartë për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Teritorit	1	III-b	1,2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist I nivelit te larte per programet e zhvillimit	1	III-b	1,2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Specialist per Shendetsine dhe Ceshjet sociale, arsimin dhe Kulturen	1	III-b	1,2	14000/12000	2%	70000	Pozicion pune shërbimi civil
	Shofer autoveture I institucionit	1	P.11/12			1%	47000	Pozicion pune me kontratë
	<b>Totali Administrata</b>	<b>13</b>						

Kryetar i Këshillit të Qarkut  
Ana VERUSHI

